

TEODOR KARECO

REFORMA AGRARE DEMOKRATIKE NGA NJË MONARK*

Kryerja e një reforme agrare në kushtet ekonomiko-shoqërore e politike që përjetonte Shqipëria në vitet '30 nuk ishte problem i thjeshtë. Në ato vite reformat agrare u konsideruan si zgjidhje të problemeve që kishin shtete të ndryshme në fushë të pronësisë mbi tokën dhe në nivelet e zhvillimit ekonomiko-shoqëror të tyre. Ato, si të thuash, ishin në “modë”.

Në gjithë ato përvoja për legjislatorin nuk ishte e thjeshtë të zgjidhje një ndër to, apo ta kopjoje sikundër vepruan vite më vonë komunistët kur erdhën në fuqi.

Jo Mbreti Zogu I nuk ishte dogmatik. Ai shtroi problemin, mbështetur në përvojat e vendeve të përparuara. Të zgjidhet ai variant që i kënaq më mirë kërkesat e ekonomisë shqiptare, për vënien e saj sa më shpejt në trasenë e ekonomisë së tregut, të shoqërisë kapitaliste, por, me kusht, të mbrohej me fanatizëm kushtetuta e vendit, të zbatohet legjislacioni në fuqi, të ruheshin të drejtat themelore të njeriut për pronën.

Përvojat e kohës ishin disa. Mbas Luftës së Parë Botërore disa shtete zbatuan reforma me *karakter politik e shoqëror*. Ato synonin të ndreqnin disa padrejtësi të vërtetuara si grabitje tokash etj. Të tilla ishin reformat që u bënë në *Çekosllovakia*, ku nëpërmjet reformës agrare ju hoq toka aristokracisë habsburgase dhe ju dha fshatarëve çekë të cilëve u ishte grabitur toka tre shekuj më parë. Në të njëjtën rrugë u veprua dhe në *Angli*, ku qeveria me shuma të mëdha nga buxheti i shtetit, stimuloi kthimin e tokës pronarëve të vjetër irlandezë të cilën e kishin grabitur në shekuj anglezët, sidomos në kohën e Kromuellit. Në *Shqipëri*, në përgjithësi nuk kishte probleme të kësaj natyre.

Është e kuptueshme që **monarkut nuk mund t'i shkonte ndërmend të zbatonte reforma të karakterit politik, si ato që u zbatuan në Rusi**, me dhunën çnjerëzore të revolucionit famëkeq të tetorit. Ato reforma të dhunshme, u konsideruan si rrugë grabitqare, të papranueshme që çonin, në fund të fundit,

* Kumesë e mbajtur në Konferencën Shkencore Ndërkombëtare me temë: “Monarkia Shqiptare, 1928-1939”, organizuar nga Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, Muzeu Historik Kombëtar, Tiranë, 1 shtator 2008.

në shkatërrimin e mëtejshëm të bujqësisë së vendit. Përvoja e shumë vendeve, përfshirë edhe Shqipërinë, e vërtetuan këtë.

Legjislatori shqiptar studioi edhe përvoja të tjera, si ato që kishin më të theksuar aspektin *shoqëror e nacional*. Në *Rumani* dhe në disa *shtete Balltike* ishin zbatuar reforma që synonin ndreqjen e disa *padrejtsive që ishin bërë në ndarjen e tokës*. Në *Poloni, Serbi dhe Greqi u zbatuan reforma të karakterit nationalist*: u përjashtuan nga pronësia mbi tokën shtetasit që përfaqësonin pakicat kombëtare. Në dy shtetet e fundit, në Serbi e Greqi e pësuan më shumë shqiptarët që jetonin në truallin e tyre.

Shtete të ndryshme, në projektimin dhe zbatimin e reformave agrare, u nisën nga qëllime diametralisht të kundërta. Me interes ishin ato që u zbatuan në *Gjermani, Angli, Norvegji, Hungari, pjesërisht në Itali* – ato kishin karakter *ekonomiko-shoqëror*.

Legjislatori shqiptar e kishte të vështirë të zgjidhte por pati krejt të qartë synimin: ai nuk kishte të bënte me reformë të karakterit politik, aq më pak revolucionar. **Shqipërinë, në vitet e monarkisë, e shqetësonte problemi ekonomik e shoqëror. Pikërisht institucionet e monarkisë studiuuan, zbuluan, miratuan dhe nisën zbatimin e një reforme agrare që, nga përmbajtja, ishte ndër më demokratiket me synim transformimet rrënjësore ekonomiko-shoqërore, në përputhje me kushtet konkrete.** Është e vërtetë që miratimi i reformës agrare të vitit '30 nga parlamenti dhe dekretimi nga Mbreti Zogu I, në vetvete, pasqyrojnë një veprim politik të caktuar në një moment të dhënë. Ky vendim politik për zgjidhjen e problemeve ekonomike e shoqërore mbartte në vetvete një përgjegjësi të madhe historike – transformimin e sigurt të ekonomisë në binaret e konceptit kapitalist.

Reforma që analizojmë nuk ishte pjellë e imagjinatës, as dëshirë e një njeriu, qoftë edhe e sovranit. E konceptuar ngushtë, si reformë mbi tokën, nga studimi që i kam bërë këtij problemi, nuk ishte domosdoshmëri. Por, **i parë problemi më gjerë – në nevojën e kapërcimit të prapambetjes, çeljes së rrugëve më efektive të ekonomisë së tregut, përsosjes së një vargu marrëdhëniesh dhe, zhvillimin më të shpejtë të ekonomisë bujqësore, atëherë gjykoj se kjo reformë ishte ndër gurët e themelit. Pikërisht, këtu unë e shoh largpamësinë e Mbretit Zog I si reformator evropian që diti në momentin e duhur, në atë kaos dhe prapambetje të përgjithshme të bujqësisë në veçanti, të gjejë instrumentat e sigurt që garantojnë përparim.** Mbreti veproi me urtësi, kishte të bënte me të ardhmen e vendit, me prosperitetin, me ruajtjen e të drejtave kushtetuese.

Është kjo arsyeja që *reformën agrare të vitit 1930 e parapriu një studim serioz i drejtuar nga Profesor Lorenxoni*. Historianët përpiqen ta minimizojnë punën e tij, madje ta denigrojnë. E verteta është se ai i bëri një analizë konkrete ekonomisë bujqësore të vendit. Me ndihmën e zotit Ago Agai, drejtor i Shkollës

Agrare të Lushnjës, u grumbulluan e u përpunuan të dhëna për 30 prona të mëdha private dhe 30 prona shtetërore. Në kushtet e mungesës së statistikave një veprim i tillë lejoi, madje, na lejon dhe sot, të nxirren konkluzione për gjendjen e bujqësisë. Vetëm mbi këtë bazë studiuesi arriti në përfundimet se çfarë reforme agrare i duhej vendit. Nuk duhet të harrojmë se **konceptet ishin ndër më demokratiket e kohës.**

Reforma agrare e vitit '30 ishte **shumëdimensionale e shumëplanëshe.** Kjo do të thotë se, iu mënjana konceptimit ideologjik. Nuk dëshiroj këtu të zgjatem për qëndrimet ndaj kësaj reforme në kohën e diktaturës komuniste dhe asaj postkomuniste që, për fat të keq është thuar se e njëjtë.

Por nuk mund të le pa përmendur imagjinatën e gabuar të profesorëve e akademistëve kur shprehen tej logjikës se, "*Ligji agrar nuk parashikonte shpronësimin e përgjithshëm të pronarëve të mëdhenj*". Historia, që përpiqen ta shtrembërojnë profesorët e indoktrinuar, dëshmon se Mbreti Zog I u tregua dy herë i vendosur në problemin e reformës agrare:

Së pari, jashtëzakonisht i vendosur dhe burrë shteti që nuk lejoi të viheshin në jetë pretendimet e ideologjisë komuniste, për të bërë të gjithë të prapronët me "pronë". Kjo do të ishte shkatërrimtare për vendin.

Së dyti, i vendosur në projektimin, miratimin dhe zbatimin e një prej reformave demokratike që garantonte zhvillimin me ritme më të shpejta të vendit, nga më i prapambeturi në Evropë, në një vend që ecte i sigurt në rrugën kapitaliste të zhvillimit.

Reforma Agrare e vitit '30 u konceptua si *tre dimensionale: 1. shpronësim të pronarëve të mëdhenj e të shtetit dhe pronësim të pronarëve pa ose me pak tokë; 2. krijimi i Bankës Bujqësore Kombëtare dhe 3. zbatimi i detyrueshëm i Kontratës Tip.* Këto dimensione u konceptuan ngushtë me njëri-tjetrin. Kjo do të thotë se, qëllimet e objektivat e reformës agrare nuk mund të arriheshin thjeshtë dhe vetëm, p.sh. duke bërë një pjesëtim të tokës duke lënë mënjane problemet thelbësore të shndërrimeve rrënjësore në kulturën e punimit të tokës në bujqësi, në përsosjen mbi baza kapitaliste të marrëdhënive të organizimit e të drejtimit etj.

Në ekonominë bujqësore, ashtu si në ekonominë në tërësi, në mënyrë figurative veprohet si në lojën e shahut: po të lëvizet një gur, detyrimisht do të lëvizë dhe një tjetër e në vazhdim gurë të tjerë, sa të fitohet loja – të bëhen shndërrimet e kërkuara në përparimin e ekonomisë.

Reforma Agrare demokratike e vitit '30, duke qenë komplekse dhe e ndërthurur, ka patur synime e konceptime të qarta e pa ekuivoke. Përmendim disa:

Së pari, ajo ka perceptim të qartë për nocionet pronë e madhe dhe ekonomi e madhe bujqësore. Në këtë kuptim, me reformën **do të ruhej ekonomia e madhe bujqësore, mbështetur mbi pronën e madhe mbi tokën, si rruga më efektive për ecjen e bujqësisë në hullinë kapitaliste të**

zhvillimit. Por, reforma agrare, si pronën e madhe dhe ekonominë e madhe, i konceptonte jo si tërësi e ngastrave të vogla të dhëna me qera, por **si një ekonomi të vetme (ferme) kapitaliste** që siguron prodhim të madh në bujqësi nëpërmjet metodave kapitaliste të organizimit e të drejtimit. Edhe prekja në masën që u gjykua e pronës së madhe, synonte të arrinte këtë qëllim të madh.

Së dyti, reforma synonte konsolidimin e fuqizimin e pronës së mesme të borgjezisë agrare, si shtylla e prodhimit bujqësor. Kjo arrihet nëpërmjet aktivizimit dhe lënies së lirë të të gjithë levave të ekonomisë së tregut, veçanërisht nëpërmjet zbatimit pa hezitim të Kodit Civil modern që garantonte copëtimin e mëtejshëm të tokës, shit-blerjen e lirë të saj.

Së treti, ajo synonte të rriste numrin e fshatarëve të vegjël të tokës nga radhët e fshatarëve pa tokë dhe të shtojë sasinë e tokës për ato familje që kanë pak tokë. Këtu mbahet parasysh që një pjesë gjithmonë e më e madhe e familjeve të kësaj kategorie të plotësojë nevojat e familjes së vet, në radhë të pare, me prodhimet e bujqësisë e blegtorisë dhe, mundësisht, të dalë në treg. Kjo u konsiderua si një ndër rrugët që çon në rritjen e prodhimit nëpërmjet nxitësve e levave të karakterit ekonomik. Rritja e pronarëve të vegjël, po të përdorim termin e kohës, rritja e numrit të pronarëve **“autonomë”**, që të kishin ekonomi **“sa për vete”**, nuk ishte qëllim në vetvete. Kjo do të zbatohet vetëm në rast se garantonte shtimin e prodhimit. Nëse një rindarje e tillë e tokës nuk lejonte shtimin e prodhimit, atëherë mekanizmat e Reformës Agrare nuk lejonin rritjen e numrit të këtyre pronarëve të vegjël. Kjo për arsye se për Reformën Agrare, ashtu si u konceptua, ishte i papranueshëm **barazimi artificial i “lumturive”**, nëse ajo rrjedh nga **barazimi i të gjithëve në mjerim**. Në thelb, Reforma Agrare nuk pranonte çdo lloj pjesëtimi të tokës pa arritur synimet ekonomike e shoqërore, nuk pranonte thjesht zgjidhjet sociale, pa ato ekonomike, **nuk pranonte, pra ndarjen dhe rindarjen e mjerimit dhe të fukarallëkut**. E ritheksojmë këtë sepse ky koncept ka ndikuar mandej në vënien në jetë dhe në zbatimin e reformës agrare, problem që historiografia nuk mund të mos e mbajë parasysh.

Toka merrej nga pronarët e mëdhenj në bazë të disa kritereve të caktuara që synonin përparimin e bujqësisë. Por edhe dhënia e tokës për fshatarët pa ose me pak tokë, u bë sipas disa kritereve, koncepteve e parimeve rigoroze, që garantonin vetëm progres. Ja cilat ishin disa nga parimet e kësaj reforme:

1. Vetëm një pjesë e tokës do t'u ndahet fshatarëve;
2. Jo të gjithë fshatarët pa tokë ose me pak tokë do të përfitonin tokë;
3. Tokë do të marrë fshatari më i mirë, ai që di ta punojë e ta ruajë;
4. Toka nuk do të jepet falas por me pagesë;
5. Toka do të jepet vetëm në plotësim të disa kushteve.

Me interes ishte fakti se një pjesë e këtyre kritereve u vunë edhe për ata që në kohën që po kryhej reforma agrare, ishin pronarë tokash, sidomos për pronarët e mëdhenj.

Reforma agrare u konceptua në mënyrë të tillë që **detyronte të gjithë kategoritë e pronarëve të tokës që ta punonin atë, ta përmirësonin, ta bonifikonin e të rrisnin prodhimin**. Vetëm kështu vinte përparimi dhe kënaqen interesat e përgjithshme të shoqërisë. Nxitej kështu konkurenca, ambicia për të arritur synimet dhe detyrat e marra përsipër. Ai që i plotësonte detyrat, më i forti, më i zoti, i kishte të gjitha mundësitë të shkonte përpara. I pazoti, dembeli, do të mbetej sërish pa tokë, për t'i dhënë mundësi të aftit.

Reforma Agrare me mënyrën që u konceptua zëvendësonte sistemin e trashëguar, të ngurtësuar e konservator me një sistem të ri nxitës e përparimtar. Me mënyrën si u konceptua reforma agrare domosdo do të kishte kundërshtime në të dy krahët: nga e djathta dhe nga e majta. Nuk mund të kishte reformë që të kënaqte njëherësh interesat e të gjitha palëve. Problemi u shtrua që të pasqyrohej në reformën agrare ai variant që i kënaqte më mirë interesat e përgjithshme dhe garantonte përparimin e bujqësisë dhe shtimin e prodhimit në kushtet konkrete të vendit.

Reforma Agrare e vitit 1930 synonte **të vinte ekuilibër, midis tre formave të ekonomive bujqësore sipas madhësisë, asaj të madhe, të mesme dhe të vogël**.

Zgjidhje të mençura e origjinale shoh edhe në konceptet e reformës agrare për ndarjen e tokës së pronarëve të mëdhenj, apo atyre që historiografia komuniste dhe ajo postkomuniste i quajnë “pronë çifligare”.

Tre koncepte u mbajtën parasysh në ndarjen e pronës së madhe të tokës:

Së pari, u përcaktua “minimumi i pacenueshëm” i tokës që do t’u lihej pronarëve të mëdhenj. Kjo ishte toka që çdo pronar do të zotëronte pa asnjë kusht. Këtu mbaheshin parasysh kushtet ekonomiko-shoqërore që përjetonte Shqipëria si dhe perspektivat e zhvillimit. Legjislatorët synonin që nëpërmjet kësaj forme të pronësisë dhe në cakun e caktuar, të mbështetej ruajtja dhe fuqizimi i ekonomive të mëdha bujqësore, për të kaluar dora-dorës edhe në ekonomi të mëdha të formës së **fermave kapitaliste**.

Ky minimum i pacenueshëm ishte **“thembra e Akilit”** për mbarëvajtjen e ekonomisë e veçanërisht të bujqësisë në Shqipëri. Si në studim dhe në Ligjin mbi Reformën Agrare u mbajt parasysh edhe përvoja e vendeve të tjera. Në studim u propozua që, çdo familje të mbante **100 hektarë tokë**. Në Ligj ky kufi **u ul në 40 hektarë**. Ky kufi ishte shumë i ulët për kushtet dhe synimet që kishte vendi. Megjithatë në kompleks, me zgjidhjet e tjera të tokës në pronësi, ky kufi mund të konsiderohet i kënaqshëm. Ka pasur edhe disa shtesa në këtë ligj që nuk po ndalem këtu.

Në përgjithësi Ligji mbi Reformën Agrare ka marrë parasysh si pronarë apo bashkëpronarë një familje të vetme. Dihet që në pjesën më të madhe, për shkak të trashëgimisë, të shitblerjeve, e njëjta tokë, kishte shumë bashkëpronarë. Ligja këtë problem me të drejtë e largpamësi e la ta zgjidhte Kodi Civil. E theksuam këtë problem, sepse vetëm kjo rrethanë, d.m.th. bashkëpronësia bënte që sasia e tokës së caktuar si **“minimum i pacenueshëm”** për shkak të pjesëtarëve të shumtë, të rritej në një masë të madhe. Nga ana tjetër kjo zvogëlonte sasinë e tokës në dispozicion të reformës agrare për shpërndarje. Me këtë shpjegohet edhe fakti që me kalimin e kohës, thjeshtë nga veprimi i këtij faktori si dhe i shitblerjes, toka në zotërim të pronarëve të mëdhenj erdhi duke u tkurrur, numri i pronarëve të mëdhenj e shumë të mëdhenj duke u minimizuar.

Së dyti, u llogarit toka “që shpronësohet”. Kjo bëhej duke zbritur nga ***“toka në pronësi”*** atë që iu la pronarëve dhe që u quajt ***“minimumi i pacenueshëm”***. Në këtë rast reforma agrare merrte në dispozicion nga pronarët për rishpërndarje ***një të tretën e kësaj toke.***

Së treti, pronarëve iu la edhe “toka e kushtëzuar” – element i ri e nxitës për ekonominë e Shqipërisë. Duke patur parasysh interesat e zhvillimit të bujqësisë dhe interesat e pronarëve të tokës si dhe mundësitë e pronarëve pa ose me pak tokë, reforma agrare i dha një zgjidhje origjinale problemit të pronësisë mbi një pjesë të rëndësishme të tokës.

Në një farë kuptimi ***“tokë kishte dhe tokë nuk kishte”***. Kjo do të thotë që në dispozicion të reformës agrare mund të vihej një sasi më e madhe tokë për shpërndarje duke shpronësuar pronarët e mëdhenj. Por në kuptimin ekonomik ajo pjesë e tokës nuk ishte e punueshme prej dhjetëra vjetësh, ishte e inonduar, kërkonte investime të mëdha për t’u vënë në qarkullim ekonomik për prodhime bujqësore. ***Afro ¼ e tokës nuk ishte e gatshme për t’u kultivuar.*** Ajo kërkonte investime suplementare, investime që bujku pa ose me pak tokë, nuk ishte në gjendje ekonomike t’i kryente.

Origjinaliteti i legjislatorit është ky: pasi zbritej nga toka në pronësi ajo që u quajt ***“minimumi i pacenueshëm”*** dhe më pas nga zbritja e 1/3 që i nënshtrohej reformës agrare, 2/3 i mbeteshin përsëri pronarit në zotërim por, me disa kushte. Prandaj kjo pjesë toke u quajt ***“tokë e kushtëzuar”***.

U quajt me këtë emërtim sepse pronari nuk ishte i lirë ta posedonte njëllë tokën që i lihej si ***“minimum i pacenueshëm”***. Interesat e ekonomisë kërkonin që toka të vihej nën kulturë, të punohej, të sistemohej, të bonifikohej, t’u nënshtrohej investimeve hidraulike. Këto dhe të tjera të kësaj natyre, nuk mund të kryheshin nga bujqit e sapobërë pronarë. Prandaj rilënia në pronësi e 2/3 të tokës ish pronarëve, ishte një akt që do t’i nxiste ata për të ruajtur këtë pronësi në të ardhmen. Por, që ta ruanin këtë pronësi, do të duhej të plotësonin disa kushte që lidheshin në mënyrë të drejtpërdrejtë me prodhimin. Nxitej kështu edhe shtimi i prodhimit dhe përdorimi i metodave të përparuara.

Në ligj thuhej shprehimisht se, **nëse brenda një afati të caktuar kohor, pronari nuk i plotësonte detyrimet, toka i shpronësohej në mënyrë të detyrueshme.** Ky element pra, supozonte të kishte një fuqi të madhe ekonomike. Natyrisht kjo do të kërkonte kohë, sepse nevojiteshin investime të mëdha, kohë që u parashikua në ligj.

Një ndër veçoritë e reformës, që dëshmon për largpamësinë e saj, është edhe fakti se në mënyrë të prerë u sanksionua **se jo të gjithë bujqit pa tokë do të bëheshin pronarë.** Marrja e një vendimi të tillë nuk u diktua thjesht dhe vetëm nga kufizimi i tokës, nga domosdoshmëria e ruajtjes së pronës së madhe apo të mesme mbi tokën. Këto ishin arsye tepër të forta dhe me ndikim të madh. Por këtu ndikuan edhe faktorë të tjerë. Natyrisht **kufizimi i tokës luajti rol përcaktues.** Nga llogaritjet e kryera nga organizmat e Reformës Agrare del se për të garantuar me tokë bujqit pa tokë dhe për të plotësuar sipas normave të kohës nevojat e bujqve me pak tokë, do të duheshin mbi 225.000 ha tokë. Dihet se, pronarët e mëdhenj të tokave me mbi 40 ha tokë, në fund të vitit 1938, zotëronin rreth 70.000 ha tokë. Ripërsërisim se konkretisht ne kushtet reale mund të shpronësohej diçka më shumë se 30.000 ha., duke përfshirë këtu si pronat private ashtu edhe ato shtetërore.

Kemi përmendur se **reforma agrare nuk u konceptua si një rrugë për ndarjen e fukarallëkut.** Ajo kishte një synim më të madh që, në tokën e shpronësuar, të organizoheshin **njësi ekonomike të pavarura,** të cilat me punën e krahut të familjes, me veglat e kafshët që zotëronin, ta punonin tokën, të siguronin prodhimin për familje, në përgjithësi mos të kishin nevojë për punë suplementare jashtë ekonomisë së tyre bujqësore. Pra, ato do të ishin të pavarura.

Është e vërtetë se reforma agrare e **zgjidhi disi në mënyrë arbitrare caktimin e tokës për frymë (gjisëm hektar) dhe për të gjithë familjen bujqësore 5 hektarë.** Kjo për arsye se toka nuk kishte të njëjtën pjellori, struktura e saj ndryshonte, një pjesë ishte mbi ujë, tjetra nën ujë, një pjesë e familjeve ishin patriarkale e të tjera të kësaj natyre. Në kushtet dhe rrethanat e kohës, me gjithë variantet e dhëna në studim, nuk u gjend zgjidhje tjetër, u pranua në një farë mase thyerja e parimit për të krijuar **“ekonomi të pavarura ekonomikisht”.** Pozitiv është fakti se këtyre ekonomive të reja u lejohej që të mbanin në kullotat komunale, përveç kafshëve të punës, edhe 15 krerë bagëti të imta dhe 4 krerë bagëti të trasha.

Nga llogaritjet e kryera në atë kohë vetëm rreth dy të tretat e bujqve pa tokë dhe me pak tokë do të përfitonin nga reforma agrare.

Nga pikëpamja ekonomike një arsyetim i tillë ishte i drejtë. Kjo pjesë e familjeve të bujqve i kishte apo mund t'i krijonte kushtet për të blerë me lehtësirat që krijonte ligja, tokën e dhënë nga reforma agrare. I kishte njëherësh kushtet për të vënë në shfrytëzim relativisht mirë tokën e përfituar. Gjithmonë

në ekonominë kapitaliste *është e nevojshme një rezervë e bujqve pa tokë për të nxitur për punimin e mirë të tokës.*

Pronari që përfitonte tokë, ishte i detyruar ta punonte atë dhe, në përputhje me kushtet, të përdorte metoda më të përparuara, të përmirësonte strukturën e mbjelljeve etj. Mosplotësimi i kushteve të caktuara bënte që **toka të rimerrej** nga organizmat e reformës agrare për t'u rishpërndarë në bujqit pa tokë. Ligji krijonte kështu një nxitje për punimin më të mirë të tokës.

Domosdo bujqit që do të përfitonin tokë, do të paguanin. Kjo ishte përvoja e vendeve demokratike që ecnin në rrugën kapitaliste të zhvillimit. Natyrisht kishte dhe përvoja “revolucionare” të ndarjes pa shpërblim të tokës. Kjo rrugë ishte e papranueshme në Shqipëri sepse vinte në kundërshtim me parimet kushtetuese të vendit. Në artikullin 198 të **Kushtetutës** thuhej shprehimisht së *“E drejta e pronësisë, për ç’farëdolloj pasunie që të jetë, asht e padhunueshme; pa mos qënë e vërtetuese rregullisht nevoja e interesit botnuer, dhe pa mos u pague vlefte e arsyeshme, si mbas ligjës së posaçme, nuk mund të shpronësohet pasunija e kurkujt”*. Ndërsa në artikullin 208 të së njëjtës kushtetutë thuhej se *“Konfiskimi asht i ndaluem dhe s’mund të bëhet veçse mbas ligjës me vendim gjyqi”*.

Me ligj u pa e domosdoshme shpronësimi, por ai nuk mund të bëhej pa shpërblim. **Çmimi mesatar** në kohën që diskutojmë ishte rreth **100 – 160 franga ari** për hektar. Përvoja tregonte se një hektar ishte shitur edhe me 600-700 franga ari hektarin.

Këto çmime as që mund të viheshin në diskutim për pronarët pa tokë dhe me pak tokë, mundësitë financiare të tyre ishin shumë shumë të kufizuara.

Edhe në këtë rast Parlamenti shqiptar u ra shumë shkurt këtyre problemeve, **miratoi një zgjidhje favorizuese – 20 fr. ari për ha.**

Së pari, çmimi i shitblerjes ishte simbolik, disa herë më i vogël së vlere reale e tokës në treg. Bujku blerës përfitonte tokë me çmim shumë të ulët.

Së dyti, shitësi, d.m.th. pronari i madh i tokave, nuk arkëtonte ndonjë të ardhur të drejtpërdrejtë. Ai merrte letra me vlerë që dëshmonin se ai ishte aksioner i Bankës Bujqësore. Në një farë kuptimi pronari i madh i tokës e falte tokën që shpronësohej nga reforma agrare.

Shteti, në krye të të cilit ishte një Monark, krijoi lehtësi shumë të mëdha për dhënien me çmim minimal të tokës që përfituan bujqit pa ose me pak tokë.

Nga historiografia është lene në harresë Kontrata Tip që është komponent i rëndësishëm e pothuaj revolucionar i reformës agrare tridimensionale

Duhet qartësuar një moment i rëndësishëm – në ekonominë e tregut gjithmonë do të ketë një numër bujqish të papronë apo me pak pronë toke, do të ketë edhe thjesht punëtorë fshati, apo sikundër i quajnë historianët tanë argatë, proletarë. Problemi u shtrua dhe u vu në procesin e zgjidhjes se cilat do të ishin

marrëdhëniet e reja me ngjyrë kapitaliste të kësaj kategorie me pronarët e mëdhenj të tokave.

Për të zgjidhur këtë problem themelor u bë një kapërcim jashtëzakonisht i madh në konceptimin e marrëdhënieve pronar-bujk. Marrëdhëniet e trashëguara të pronarit me bujkun ishin anakronike, nuk i përgjigjeshin marrëdhënieve të reja të krijuara. Bujku ishte i lidhur me zotërinë, pronarin e tokës dhe nuk kishte të drejtë të lëvizte nga prona apo të vepronte i pavarur. Të ruaje këto marrëdhënie do të thoshte të **konservoje prapambetjen**, t'u mbyllje rrugën elementëve të rinj e përparimtare të ecurisë së ekonomisë bujqësore.

Hapi revolucionar pa revolucion që bëri reforma agrare, ishte **suprimimi i mbajtjes bujk**. Ky ishte akt me rëndësi epokale për transformimin e bujqësisë, për ngritjen e ndërtesës së ëndërruar kapitaliste.

Vetëm duke suprimuar sistemin e mbajtjes bujk mund të hidhej hapi i dytë – **vendosja e marrëdhënieve të reja midis pronarëve dhe bujqve sipërmarrës, mbështetur në kontratën e konceptuar mbi bazat e drejtimit dhe organizimit kapitalist**. Këto marrëdhënie të reja juridike dhe ekonomike i interesonin jo vetëm zhvillimit e përparimit të bujqësisë, por edhe palëve: pronarit dhe sipërmarrësit që merrte në përdorim me qira tokën.

Së pari, pronari i tokës të shndërrohet dora-dorës nga “zotëri”, në fermer, në “bujk” me konceptin e atyre viteve. Shndërrime të tilla, megjithëse do të kryheshin me evolucion, dalëngadalë, në të vërtetë ishin **revolucion në thyerjen e praktikave, koncepteve, marrëdhënieve të trashëguara**. Për legjislatorin ishte e qartë se ky problem nuk do të zgjidhej shpejt dhe vetvetiu, ai hynte në vorbullën e atyre marrëdhënieve që ndërrojnë me shumë vështirësi. Por vlera e reformës agrare të vitit 1930 rritet pikërisht se **parashikon, vendos, sanksionon, ato dukuri që do të duhet objektivisht të zbatohen në bujqësinë e Shqipërisë në rrugën e nisur tashmë drejt kapitalizmit**. Pa to as që mund të paramendohet kapërcimi i prapambetjes së bujqësisë, qoftë edhe duke bërë rindarje tërësore të tokës.

Fermeri pronar, në këto kushte, do të merrte përsipër të gjithë mbarëvajtjen e fermës në pronësi, të bënte drejtpërdrejt organizimin e drejtimit e saj sipas modelit kapitalist, të zgjidhte problemet teknike dhe ta miradministronte atë.

Së dyti, “bujku” më parë i konceptuar me lidhje të panumërta e të pazgjidhshme me “zotërinë”, të shndërrohej në sipërmarrës për punimin e tokës. Në këtë rast sipas kontratës sipërmarrësi detyrohej të zbatonte të gjitha detyrat e vëna nga fermeri për mënyrën e punimit të tokës, për qarkullimet bujqësore, për llojin e prodhimit e të tjera të kësaj natyre. Sipërmarrësi, në mbështetje të kontratës, detyrohej të punonte në mënyrë intensive tokën e marrë në sipërmarrje, të rriste më tej tokën e punuar duke zvogëluar tokën e livadheve, çaireve, kullotave.

U kërkua kështu që palët në kontratë të ndërronin konceptet. Më e madhe ishte përgjegjësia e pronarit të tokës në përmbushjen e mandatit që u jepej si ndaj shoqërisë dhe ndaj shtetit. Një pronar i tillë i shndërruar në fermer kapitalist do të ishte ndër faktorët vendimtarë për përparimin e bujqësisë. Ai, së bashku me sipërmarrësin e mveshur me detyrime e interesa të reja, do të ishte mbështetje e sigurt drejt progresit të synuar.

Duke mos e konceptuar reformën thjesht si shpronësim dhe dhënie toke, ligjvënësi, i dha një **frymëmarrje më të gjerë asaj në fushën e marrëdhënieve.**

Kemi të bëjmë me **një element të ri që pothuaj nuk përmendej nga historiografia jonë.** Kontrata tip, pra marrëdhëniet midis fermerit pronar dhe sipërmarrësit, bujkut pa ose me pak tokë do të zbatoheshin jo vetëm në tokat që do të prekeshin apo do përfitoheshin nga reforma agrare, por **në gjithë bujqësinë e vendit.** Pra, kontrata tip do të zbatoheshin në të gjitha ato raste kur lindnin marrëdhënie midis pronarit të tokës dhe bujkut sipërmarrës për punimin e saj.

Me rëndësi ishte fakti se kontrata tip, pasi nënshkruhej, merrte fuqi ligjore. Nuk mund të ndryshohej në mënyrë të njëanshme apo arbitrare.

Me reformën agrare dhe kontratën tip u zgjidhën edhe një varg problemesh të tjera që kishin të bënin me çrrënjosjen më tej të marrëdhënieve të sistemit të vjetër, të trashëguara nga e kaluara. Ndër to përmendim:

Së pari, u ndalua më ligj puna angari dhe dhuratat për pronarin.

Së dyti, në marrëdhëniet e huas midis pronarit dhe bujkut qiramarrës – hiqej kamata apo interesi.

Së treti, pronari u detyrua të përballonte investimet që rridhnin nga kanalizimet dhe veprat hidraulike relativisht të mëdha.

Së katërti, pronari detyrohej t'i jepte pa qira bujkut sipërmarrës shtëpi, tokën rreth shtëpisë, hambarin, kashtoren, lëmin dhe 1 dynim tokë ngjitur me shtëpinë. Interesant ishte fakti se, kërkoheshin që shtëpia të ishte në kushte të mira higjieno-sanitare, të plotësonte kërkesat e një banimi normal.

Së pesti, bujku sipërmarrës përdorte kullotat për një numër të caktuar bagëtish pa pagesë, priste dru në pyll.

Së gjashti, kur çelte tokë të re bujku sipërmarrës të gjithë prodhimin e mban për familjen e tij, duke mos paguar detyrimet kontraktore si për pjesën tjetër të tokës.

Këto ishin kapërcime të rëndësishme që garantonin përsosjen e marrëdhënieve kapitaliste në bujqësi.

Reforma Agrare demokratike e vitit 1930 ishte **ndër reformat më të plota, më komplekse,** për shkak të detyrave e synimeve që i kishte vënë vetes. Pjesë integrale e saj ishte dhe **“Krijimi i Bankës Bujqësore”.**

Nuk mund të kryhej si duhej reforma agrare në tërë gjerësinë e thellësinë e vet pa i hapur rrugë kreditit agrar, si një ndër çelësat themelore për

kapërcimin e prapambetjes së bujqësisë dhe për ecjen përpara të saj. Ishte guxim jashtëzakonisht i madh për kohën, në kushtet e prapambetjes së thellë të vendit, të mungesës së burimeve financiare etj., të projektoje dhe miratoje një **program kaq të gjerë shumë-dimensional.**

Kjo bankë u konceptua, në radhë të parë, si **bankë vetëm me kapital shqiptar.** Një tjetër parim i vendosur ishte se **shteti do të ishte ndër aksionistët kryesorë** të bankës dhe do të ndikonte direkt apo indirekt për të gjetur aksionistët dhe burimet financiare për të plotësuar kapitalin e bankës. Për vetë rrethanat, mungesën e burimeve financiare, kjo bankë do të jepte vetëm kredi afatshkurtër dhe afatmesëm për problemet korente të zhvillimit të bujqësisë.

Nga historiografia komuniste e postkomuniste është konsideruar si faktor negativ zgjatja e stërzgjatja e zbatimit të reformës agrare të vitit '30 dhe se ajo u shty në **“kalendrat greke”**. Në fakt, **reforma u projektua të kryhej në 10 vjet.** Sa e kam studiuar këtë problem edhe ky afat, në kushtet e financave të dobëta të Monarkisë, të gjendjes së dëshiruar teknike – ishte pothuaj euforik. Madje, në rrugë e sipër, dolën edhe faktorë të panjohur. Ndikoi kriza botërore dhe, mbi të gjitha **pushtimi i Italisë fashiste e ndërpreu para kohe vazhdimin e reformës agrare demokratike.**

Po jap dy shembuj. Në radhë të parë, numri i teknikëve numërohej me gishta. Ata u përgatitën në dy kurset e viteve 1931-1933 nën drejtimin e inxhinierit shqiptar Selim Zyma. Për t'u theksuar ishte fakti se nga 50.000 fr. ari që kërkuan specialistet e huaj për kursin inxhinieri shqiptar e bëri falas. Pra në terren punonin vetëm 5 grupe teknike që u duhej të përballonin një volum të madh pune. Nga ana tjetër, kosto e punimeve erdhi duke u rritur. **Për një hektar** të shpronësuar dhe të shpërndarë për instalimin e fshatarëve pa tokë, me pak tokë dhe të emigrantëve **u harxhuan 117 fr. ari.** Kujtojmë se vetë fshatari paguante vetëm 20 fr. ari për tokën e përfituar.

Megjithë kohën jo të mjaftueshme, me gjithë faktorët e rinj frenues, reforma agrare demokratike arriti synimet e veta komplekse me sukses. Ndër arritjet përmenden:

Së pari: ndryshimet sasiore e cilësore shumë të mëdha të tokës së punueshme dhe, rrjedhimisht rritja e prodhimit bujqësor e blegtoral.

Reforma Agrare nuk ishte qëllim në vetvete, vetëm të shpronësonte apo pronësonte. Ajo synonte zhvillimin në tërësi të bujqësisë të vendit. Dhe, në kushtet e kufizuara të tokës, veçanërisht asaj në shërbim të drejtpërdrejtë të kultivimit të bimëve të arave, **domosdo që rritja e tokës së punueshme ishte ndër treguesit më të rëndësishëm. Ky ishte përfitimi, në rrafshin strategjik, i pasojave të reformës agrare.** Veprimi në mënyrë të ndërsjellë e kompleks i gjithë masave, të dukshme e të padukshme të reformës çoi në rritjen

sistematike e në përpjesëtime të mëdha të tokës së punueshme. Në shkallë vendi këto dukuri shihen në të dhënat që vijojnë:

Ndryshimi i strukturës së tokës bujqësore në Shqipëri për vitet 1929-1932, 1938 dhe 1945-1946, në hektar

Zërat e kadastrës	Mesatarisht për vitet 1929-1932, ha	1938 në ha	Mesatarisht për vitet 1945-1946, ha
Toka bujqësore gjithsej	1.125.000	1.180.000	1.186.509
a.Toka nën kulturë	155.000	292.000	305.509
b.Livadhe	60.000	39.000	35.000
c.Kullota	910.000	849.000	845.000

Shifrat janë kokëfortë, historianët tanë nuk mund të mos i pasqyrojnë ato. Megjithëse toka bujqësore në tërësi ishte rritur relativisht pak duke shfrytëzuar tokën për pyjet e degraduara dhe një pjesë të sipërfaqes së tokës jo produktive, ndryshimet më të rëndësishme janë bërë brënda saj. Pothuaj **u dyfishua toka nënkulturë – dukuri që shënoi edhe arritjen më të madhe të Reformës Agrare demokratike të vitit 1930.**

Në këtë proces **nuk ndikuan thjeshte dhe vetëm masat e shpronësimit apo të pronësimit.** Ato ndikuan vetëm në një farë masë. Në këtë dukuri ndikoi **në tërësi kompleksi i masave të projektuara dhe të zbatuara nga reforma agrare demokratike e vitit 1930.** Ndër to, ndikoi edhe copëtimi i natyrshëm, me frymën e kësaj reforme, i pronës së madhe në përputhje me kërkesat e Kodit Civil, për ndarjen e saj midis bashkëpronarëve të shumtë, trashëgimeve etj. Gjithë këto janë procese të drejta dhe ekonomike. Duke u shtuar numri i pronave, çdo ekonomi ka synuar që të shtojë tokën e punueshme apo nën kulturë, duke zvogëluar sipërfaqet e lëna për livadhe e kullota. Madje edhe këto të fundit, duke i shfrytëzuar me efektivitet më të lartë, pasi gjatë kësaj periudhe kohore është shtuar edhe numri i krerëve të bagëtisë.

Ky ishte ndikim i drejtpërdrejtë i konceptimit në hullinë kapitaliste dhe u formulua e u zbatua nga reforma e atyre viteve.

Shtimi i dukshëm i sipërfaqes nën kulturë ishte garanci për rritjen e prodhimit. Ritmet e shtimit të prodhimit bujqësor u vërtetuan më të larta se ritmet e shtimit të popullsisë gjatë periudhës që shqyrtojmë. Nga ana tjetër përqendrimi i vëmendjes në bujqësi nëpërmjet zbatimit të reformës agrare dha dhe një dukuri të re – prodhimi me origjinë nga bujqësia, sikundër pritej, u shtua me ritme më të shpejta se prodhimi me origjinë nga blegtoaria. Në këtë periudhë historike këto ndryshime progresive u vërtetuan në rrugën ekstensive të zhvillimit. Ja disa të dhëna:

Rritja në vitin 1938 në krahasim me mesataren e viteve 1929-1932 në përqindje

-Prodhimi i përgjithshëm bujqësor	
nga ky:	124,1
-me origjinë nga bujqësia	131,8
-me origjinë nga blegtoria	120.0

Edhe në natyrë prodhimi bujqësor erdhi duke u rritur:

**Prodhimi në natyrë i drithërave dhe disa produkteve
blegtorale mesatarisht për vitet 1929-1932 dhe vitin 1938
(në ton)**

	Mesatarisht për vitet 1929- 32	Viti 1938
Misër	100.800	143.750
Grurë	32.230	38.570
Thekër	2.220	3.080
Elb	5.140	4.760
Tërshërë	10.170	8.250
Drithërat gjithsej	150.560	198.410
Mish	12.410	14.750
Bulmet	54.170	69.918

Ndërsa popullsia ishte shtuar rreth 15 për qind, prodhimi i misrit ishte shtuar mbi 43 për qind, prodhimi i drithërave gjithsej afro 32 për qind.

Me këto dhe të dhëna të tjera të kësaj natyre nuk synohet të paraqiten sukseset e “shkëlqyera” të monarkisë. Jap vetëm **një pjesë të prirjeve historike që u vërtetuan në vitet 1912-1938 në ecjen e bujqësisë**, prirje që nuk mund të shtrembërohen, duke deklaruar **absurditete** të natyrës se **“fshatarësia është varfëruar”** gjatë kësaj periudhe. *Së dyti*, Reforma Agrare demokratike e vitit 1930 **zgjidhi në mënyrë optimale problemet që shtroheshin për pronësinë e madhe mbi tokën**. U shpërbënë në mënyrë rrënjësore pronat shumë të mëdha, apo ato që historiografia komuniste ka dëshirë t’i quajë “çifligje”. Duke u mbështetur në synimet e kësaj reforme që të ruheshin ekonomitë e mëdha në kufi optimalë, ato u shpërbënë.

Natyrisht reforma agrare i dha një **shtysë më të madhe, më të drejtpërdrejtë, jo thjeshtë nëpërmjet shpronësimeve por, nëpërmjet frymës së marrëdhënieve kapitaliste që ajo diktonte. Ja disa të dhëna:**

Grupimi i ekonomive të mëdha sipas madhësisë së pronës
së tokës në vitet 1929 dhe 1945

Grupimi i pronës së madhe të tokës në ha	Numri i pronave të mëdha në vitet:		Toka në ha në vitin 1929	Toka në ha në vitin 1945
	1929	1945		
5.000 ha e lart	7	-	38.500	-

2.000 – 4.999 ha	9	-	28.500	-
1.000 – 1.999 ha	9	-	10.300	-
500 – 999 ha	6	-	3.700	-
300 – 499 ha	11	-	4.000	-
200 – 299 ha	9	-	1.900	
Mbi 200 ha (vetëm për vitin 1945 se mungojnë të dhënat e detajuara)	-	43	-	13.859
100 – 199 ha	19	60	2.493	7.446
50 – 99 ha	12	160	675	9.845
Shuma gjithsej	82	263	90.068	31.150

Të dhënat e përpunuara, nga arkivat, me rezervat përkatëse, tregojnë se në fushën e pronësisë së madhe ishte bërë një kapërcim i rëndësishëm. Natyrisht këtë nuk ja atribuojmë thjeshtë dhe vetëm reformës agrare, si në anët e dukshme dhe të padukshme të saj. Në këtë proces **ndikim të madh e të pazëvendësueshëm luajtën faktorët e rregullimit ligjor të pronës si dhe të shitblerjes**. Por meqë krahasimin kohor e bëjmë deri në vitin 1945, domosdo, në vitet pas 1939-s, ndikoi edhe **“gogoli” komunist**. Gjithsesi për periudhën që shqyrtuam **nga 90.068 ha** që ishte toka në pronësi të pronarëve që zotëronin mbi 50 ha tokë në vitin 1929, në vitin 1945 arriti **në 31.150 ha. Pra u zvogëlua rreth 3 herë**.

Konkluzioni - procesi i pronësisë së madhe po ecte në hullinë që projektoi dhe zbatoi reforma agrare. Pronësitë shumë të mëdha, të pa manovrueshme nga ana ekonomike, u mënjanuan nga skena e bujqësisë shqiptare. Ndërsa në vitin 1929 kishte 82 pronarë që i takonte mesatarisht 1.098 ha për një ekonomi, në vitin 1945 numri i tyre arriti në 263. Por madhësia mesatare e tokës në vitin 1945 ishte vetëm 118 ha, d.m.th. rreth 10 herë më e vogël. Kështu prona e madhe u bë më optimale, i përgjigjej kërkesave për të ecur më e sigurt në rrugën e fermave kapitaliste. Kjo ecuri normale çonte edhe në një konkluzion tjetër. Duke përjashtuar tokën në pronësi të shtetit, ndër pronarët e mëdhenj të tokave nuk kish mbetur ndonjë sasi e madhe toke për t’u shpronësuar e për t’ia dhënë fshatarëve pa dhe me pak tokë.

Se treti, në procesin e përgjithshëm të shpërbërjes e të tkurrjes së pronës së madhe e shumë të madhe për tokën, në përputhje me synimet e reformës agrare **erdhi duke fituar më shumë terren prona e borgjezisë agrare, e fshatarëve të pasur dhe të mesëm**. Kjo ishte shtylla e përparimit të bujqësisë, pjesa më e ndjeshme, konkruuese, që drejtonte ekonominë bujqësore në përgjithësi, sipas lojës dhe kërkesave të tregut. Ishte ajo masë ekonomish që mbante të gjallë edhe tregun, si të brendshëm ashtu edhe të jashtëm.

Vetëm **në procesin e zbatimit të reformës agrare**, veçanërisht me shtrirjen në gjërësi e thellësi të proceseve të shit-blerjes së tokës, me shpërbërjen e pronarëve të mëdhenj e shumë të mëdhenj të tokave me format që

përmendëm, **lindi borgjezia agrare që forcohej çdo ditë e më shumë**. Kjo kategori ishte ndër garancitë e përparimit të bujqësisë shqiptare.

Në duart e borgjezisë agrare u përqendrua 40 për qind e tokës në pronësi në periudhën që shqyrtojmë. Ky është ndër hapat e suksesshme të Reformës Agrare demokratike të vitit 1930. Po çelëj traseja që ekonomia të ecte më mirë dhe më e sigurt në arritjen e qëllimit të madh të vënë në dobi të përparimit të bujqësisë në rrugën e ekonomisë së tregut.

Së katërti, jashtë dukurive pozitive e progresive nuk mund të qëndronte edhe kategoria *e ekonomive bujqësore pa tokë dhe me pak tokë*. Megjithëse kufizimi i tokës nënkulturë në pronësi në periudhën që shqyrtojmë nuk lejonte ndryshime thelbësore për këtë kategori të ekonomive bujqësore, përsëri *u hodhën hapa të mira përpara*. Në mënyrë të përmbledhur këtë e shohim në:

a. *zvogëlimin e fshatarëve pa tokë, apo të atyre që quheshin “çifçinj”.*

Megjithëse reforma agrare nuk mori dhe nuk kish si të merrte përsipër që këtë kategori ta bënte të gjithë “pronarë”, përsëri si numër pati ndryshime. Kështu nga reforma agrare në vitet '30 kjo kategori e bujqve pa tokë llogaritej në 18.063 ndërsa në vitin 1945 u zvogëluar në 13.862 familje. Ky është një hap inkurajues.

b. *në pronarët e vegjël po rritej ndikimi ekonomik i familjeve me më shumë tokë*. Në vitin 1945 ndërsa familjet që zotëronin nga 3-5 ha secila zinin në totalin e familjeve 12 për qind, ato zotëronin rreth 18 për qind të tokës në pronësi.

Së pesti, rezultate inkurajuese u arritën edhe në atë që është treguesi më direkt dhe më i dukshëm i reformës agrare demokratike – shpronësimin e pronarëve të mëdhenj dhe shtetit dhe pronësimin e ekonomive pa ose me pak tokë.

Për vetë rrethanat deri në fund të vitit 1938 u arrit të kryheshin matjet teknike sipas të gjitha rregullave të vendosura, u bënë planet përkatëse dhe u **zbatua reforma agrare në 13.062.9 ha** në pronësi të pronarëve të mëdhenj të tokës dhe të shtetit. Nga kjo tokë duke zbatuar me rigorozitet kërkesat e ligjit u pronësuan **1.905 pronarë të rinj**, duke përfshirë këtu edhe një pjesë të emigrantëve. Gjithsej pronarët e rinj **përfituan 6.375, 7 ha tokë**.

Deri në korrik të vitit **1939 ishte bërë punë që mbeti në proces**. Kështu përmendim se pronat e marra në dorëzim, të matura, plani i sipërfaqes zinin një vëllim të madh në punën e organizmave të reformës agrare. Për to **nuk kishte arritur të bëhej puna e fundit – dorëzimi i këtyre tokave tek fshatarët pa tokë apo me pak tokë**. Nga dokumentat del se, në **pronat private**, kishte **përfunduar puna tërësisht në mbi 22 mijë hektarë**. E njëjta ishte bërë për pronat **shtetërore** të tokës për rreth **5 mijë hektarë**. U ndërpre procesi i dhënies së tokës për shkaqet madhore të pushtimit të vendit.

Të bëjmë disa llogari. Tokat ku kishin përfunduar matjet dhe ishin marrë në dorëzim nga reforma agrare, mund tu jepeshin fshatarëve pa dhe me pak tokë. Ato zinin rreth 7.000 ha të pronave private dhe rreth 5.000 ha të pronave shtetërore, **gjithsej 12.000 ha**. Pra, në këtë mënyrë në vitet 1932-1939 **u shpërndanë apo ishin tërësisht gati për t'u shpërndarë mbi 18.000 ha tokë**. Kjo do të bënte pronarë rreth **5-6 mijë fshatarë të tjerë**.

Nga rreth 30.000 ha që ishin mundësitë e reformës agrare për t'i shpronësuar pronarët e mëdhenj dhe për të pronësuar fshatarët pa ose me pak tokë, ishin gati për tu shpërndarë 18.000 ha. Pra nga ana statistikore **reforma ishte në pragun e realizimit rreth 60 për qind**, në se mund të shprehemi me shifra

Këtu do mbajtur parasysh edhe një moment tjetër i rëndësishëm. Reforma agrare po ecte me shpejtësi në shpërbërjen e pronës së madhe, format i përmendëm. Në vitin 1945 statistikatat dhe dokumentat e kohës thonë se kishte vetëm 82 ekonomi të atyre që i quajmë pronarë të mëdhenj që zotëronin mbi 50 hektarë tokë e që zotëronin gjithsej 31.150 ha. Pra, raporti u përmbys. Përveç pronave shtetërore që, në përgjithësi ishin larg kërkesave për shfrytëzimin për qëllime bujqësore për shkak se pjesa më e madhe nuk ishte nën kulturë, **duheshin gjendur rrugë të tjera për shtimin e sipërfaqeve dhe dhënien e tyre fshatarëve pa dhe me pak tokë**.

Në përfundim mund të themi se megjithëse Reforma Agrare demokratike e vitit 1930 ishte e parakohshme, disi euforike për afatet, ishte një reformë komplekse që i dha shtysë zhvillimit të bujqësisë, futjes së saj me hapa më të shpejta në hullinë e rrugës kapitaliste. **Peshorja e gjykimit historik të reformës agrare anon gjithmonë nga arritjet, ndikimi pozitiv në proceset drejt ekonomisë së tregut**. Kësaj reforme duhej t'i jepej vendi që meritonte në Historinë e Popullit Shqiptar.

Sot, në 80-vjetorin e Monarkisë, nuk mund të mos nderojmë e respektojmë punën e frytshme të bërë nga i vetmi reformator i dëgjuar shqiptar – Mbreti Zog I. Këtë e them me bindje si shqiptar, shkencëtar, ekonomist që ka studiuar me themel aspekte të veçanta të veprimtarisë së Tij. Ka ardhur koha që këtij personaliteti shtetëror t'i jepet jo vetëm vendi i duhur në histori, vend që u mohua nga sistemi komunist, por të bëhet vlerësimi real. Gjykoj se si shtetar, **Mbreti Zog I do të duhej të vlerësohej me të gjitha titujt më të lartë të Shqipërisë. Ai është reformatori demokrat që vuri themelet e një shteti që ecte i sigurt në rrugën kapitaliste të zhvillimit**.

Bibliografia:

Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë (AQSH).

AQSH, Fondi 894, viti 1939, dosja 600. Dokumenti: “Pasqyrë mbi Statistikën-bujqësore të “REFORMËS AGRARE”, përpiluar simbas shënimeve dhe dokumentave

- disponibël n'arshivat e Seksionit të Reformës Agrare pranë P.T. Ministris s'Ekonomis Kombëtare.
- AQSH: Fondi 279, viti 1929. Letra e Etoze Melis, nëndrejtor i degës së Bankës Kombëtare të Shqipërisë në Tiranë, dërguar Amedeo Gambinos, Këshilltar delegat i Bankës Kombëtare të Shqipërisë në Romë, dt. 9.4.1929, me të cilën përcillej dokumenti me lëndë "Reforma Agrare në Shqipëri". Bashkangjitur me këtë letër janë 9 tabela për çifliqet në Shqipëri me klasifikim sipas prefekturave.
- FISHTA, Iljaz - *Sistemi monetar dhe i kreditit në Shqipëri (1925-1944)*, Botim i Universitetit të Tiranës, Fakulteti i Ekonomisë, Tiranë, 1971.
- FISHTA, Iljaz – TOÇI, Veniamin - *Gjendja ekonomike e Shqipërisë në vitet 1912-1944, prapambetja e saj, shkaqet dhe pasojat*, Tiranë: 1983.
- FISHTA, Iljaz & DOÇI, Muharem – "Ndërhyrja e kapitalit të huaj në bujqësinë e Shqipërisë në periudhën 1925-1944", në: revista *Ekonomia Popullore*, nr. 3, 1965.
- FISHTA, Iljaz & KARECO, Theodor - *Prona Private në Shqipëri 1924-1944 (përmes burimeve arkivore e bibliografike)*, Tiranë: Botim i Shtëpisë Botuese "DITURIA", 1996.
- Fletorja zyrtare, 1945-1944.*
- Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. III, (Periudha e Pavarësisë, 28 Nëntor 1912-1917, Prill 1939), Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë: Botimet "Toena", 2007.
- KALMES - *La situation economique et financiere de l'Albanie*, Geneve: Septembre, 1922.
- KARECO, Teodor - *Reforma Agrare Demokratike 1930*, studim i përgatitur për botim.
- "Masat për rimëkëmbjen dhe zhvillimin e bujqësisë në vitet 1944-1946". Artikull i botuar në revistën *Studime Historike* të Institutit të Historisë të Akademisë së Shkencave të RPSSH, nr. 2, viti 1980, f. 93.
 - "Reth zhvillimit të forcave prodhuese në industri gjatë viteve 1920-1940", *Studime historike*, nr. 4/1965, botim i Universitetit të Tiranës, Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, Tiranë: 1965.
- Ligjë mbi Reformën Agrare, mbi Bankën Bujqësore e mbi Kontratën-Typ*; Mbretinija Shqiptare, Kryesija e Këshillit Ministrues; neni 66, faqe 27; Durrës, Punëra Grafike "Stamles", 1931. Shih edhe: AQSH, fondi 273, viti 1931, dosja 162.
- LORENZONI, Giovanni - Universiteti Mbretinuer i Firences: *ÇËSHTJA AGRARE SHQIPTARE*, studime, vëzhgime dhe propozime për një reformë Agrare në Shqipëri, Tiranë: Shtypshkronja "Mbrothësija" Kristo P. Luarasi, 1930.
- PANO, Aristotel – "Llogaritjet e para të të ardhurave kombëtare dhe analiza e tyre kritike", në *Referate e kumtesa*, botim i USHT, Fakulteti i Ekonomisë, 1967.
- SHKOZA, Haxhi - *Financat Shqiptare (1839-1934)*, Tiranë: 1935.
- Shqipëria më 1937*, vëll. I, Tiranë, 1937
- Shqipëria më 1937*, vëll. II, Tiranë, 1938.

